Policia iu bën shenjë të ndalojnë, 5 të rinj rrezikojnë jetën e efektivëve dhe arratisen. Pas ndjekjes kapet një prej tyre, në kërkim dhe 30-vjeçari që...(Emri)

25 Shkurt, 2025 15:50

Madhësia e tekstit:

Policia iu bën shenjë të ndalojnë, 5 të rinj nuk i binden urdhrit dhe rrezikojnë jetën e efektivëve. Pas ndjekjes kapet një prej tyre, në kërkim dhe 30-vjeçari Inez Hajrulla që i shpëtoi 2 atentateve

Bashkë me Hajrullan janë shpallur në kërkim edhe tre persona të tjerë, pjesë e të njëjtit grup kriminal.

30-vjeçari ka qenë objektiv i dy atentateve në qytetin e Vlorës. Në vitin 2017, Hajrulla ishte pre e një atentati me tritol ku mori dëmtime të rënda në të dyja këmbët.

Më pas atij iu bë atentat me 10 Maj të vitit 2019 në lagjen "Uji i Ftohtë" në Vlorë, ku Hajrulla u qëllua me armë zjarri nga një automjet në lëvizje, teksa ishte ulur në një lokal.

Hajrulla i shpëtoi atentatit, por u plagos rastësisht Dajko Cenodemaj që po pinte kafe në Lungomare me disa miq. Autorët pasi u larguan dogjën automjetin në Babicë të Vogël.

Policia deklaroi se të pestë personat janë pjesëtarë të një grupi kriminal me aktivitet në fushën e krimeve kundër personit.

Gjatë operacionit u sekuestruan municion luftarak, jelek antiplumb, targa automjetesh të vjedhura, një shumë parash, veshje dhe radio si të Policisë, që u gjetën në banesën dhe në biznesin e 2 prej këtyre shtetasve.



Por çfarë ndodhi mbrëmë në Vlorë?

Policia e Vlorës ka zhvilluar kontrolle të shtuara, bazuar në inteligjencën informative, për kapjen e personave në kërkim dhe të atyre që qarkullojnë me armë zjarri apo lëndë narkotike.

Gjatë kontrollit, kundërshtuan punonjësit e Policisë, vihet në pranga 1 shtetas, shpallen në kërkim 4 të tjerë, të pestë pjesëtarë të një grupi kriminal me aktivitet në fushën e krimeve kundër personit.

Sekuestrohen municion luftarak, jelek antiplumb, targa automjetesh të vjedhura, një shumë parash, veshje dhe radio si të Policisë, që u gjetën në banesën dhe në biznesin e 2 prej këtyre shtetasve.

Në lagjen "Pavarësia", shërbimet e Policisë i kanë bërë shenjë ndalimi një automjeti tip "Toyota", pasi kishin dyshime se me të qarkullonin shtetas me precedent kriminal që mund të mbanin sende të kundërligjshme.

Drejtuesi i automjetit nuk i është bindur urdhrit për të ndaluar dhe është larguar me shpejtësi me automjet, bashkë me pasagjerët, duke rrezikuar jetën e punonjësve të Policisë.

Shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë janë vënë në ndjekje të automjetit tip "Toyota", me qëllim identifikimin dhe kapjen e shtetasve që qarkullonin me këtë automjet.

Si rezultat i veprimeve hetimore, u bë i mundur identifikimi i këtyre shtetasve dhe me miratim të organit të procedurës u ushtruan kontrolle intensive, në ambiente të ndryshme dhe në banesat e tyre, me qëllim kapjen e këtyre shtetasve dhe sekuestrimin e sendeve të kundërligjshme, nisur dhe nga informacionet e siguuara përmes inteligjencës informative se këta shtetas ishin pjesëtarë të një grupi kriminal dhe mund të fshihnin sende të kundërligjshme në banesat e tyre.

Në vijim të veprimeve u bë i mundur lokalizimi dhe arrestimi në flagrancë i njëriit prej 5 personave që qarkullonin me automjetin tip "Toyota", konkretisht shtetasi D. K., 29 vjeç, banues në Vlorë.

Gjithashtu, u shpallën në kërkim shtetasit Inez Hajrulla, 30 vjeç, O. K., 33 vjeç, E. H., 32 vjeç dhe K. I., 31 vjeç, banues në Vlorë.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit O. K. dhe në biznesin (servis automjetesh) e shtetasit D. K., shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan veshje (uniforma) dhe radio si të Policisë, i jelek antipulmb, targa automjetesh të dyshuara të vjedhura, një shumë parash, municion luftarak, dhe sende të tjera, që dyshohet se i shërbenin veprimtarisë së grupit kriminal në të cilin bënin pjesë këta shtetas.

Vijojnë kontrollet intensive nga strukturat e DVP Vlorë, në bashkëpunim me Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë Tiranë dhe Fier, për lokalizimin dhe kapjen e 4 shtetasve të shpallur në kërkim.

Gjithashtu, nën drejtimin e Prokurorisë së Vlorës, vijon puna për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarjeje dhe për dokumentimin e plotë të veprimtarisë kriminale të këtyre shtetasve.

Materialet iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

(BalkanWeb)

Per t'u bërë pjesë e grupit '**Balkanweb**' mjafton të klikosë: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: arrestim | polici | Vlore

BW | GET IT ON Google Play

Kërko këtu

LAJMET E FUNDIT

"Nuk do ia dalin të na mbyllin gojën"/ U paditi për shpëlje, Killiçi: G.NXQ më shpëlli të paligshëm! 14 maj po afron dhe...

25 Shkurt, 2025

Gjytetarët që kalojnë vettingun, me aftësi të ulëta profesionale. Adrian Shega dha vendim për "Prestige Resort", pasë ai u shemb

25 Shkurt, 2025

Banorët e Spitalëës në protestë: Nuk kemi ku kalojmë, na dërrë dëmtuar puna, duam ngjidhje

Klodjana Hasholaj | 25 Shkurt, 2025

You control your privacy

English

Please review your privacy preferences as there are updates to the list of vendors that process your data.

When you use this site, we and our vendors process data from you and your device. This data can include your type of browser, settings, cookies, unique identifiers, IP address, and geo location. Once dismissed, these settings can be accessed again from the link in our privacy policy or footer.

We're requesting consent to offer: Personalized ads and content, ad and content measurement, audience insights and product development

Ads and content can be personalized based on a profile. More data can be added to better personalise ads and content. Ad and content performance can be measured. Insights about audiences who saw the ads and content can be derived. Data can be used to build or improve user experience, systems and software.

Advanced Settings | Accept

Your consents are specific to this site & device.

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@Balkanweb

© 2025 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.